




Pasqyra Makroekonomike publikohet nga Ministria e Financave çdo tre muaj dhe ka për qëllim informimin për zhvillimet tremujore ekonomike në Kosovë

Sektori Real


Ekonomia vendore pritet të rritet me rreth 4.3% përgjatë vitit 2018, në terma real. Rritja ekonomike do të vazhdojë të jetë e nxitur kryesisht nga të njëjtët shtytës (investimet, eksporti, konsumi privat, eksporti), mirëpo rritja e konsumit dhe eksporti i shërbimeve pritet të kenë rol më të theksuar në rritjen e BPV-së. Kontributi veçantë në këtë rritje të aktivitetit ekonomik vlerësohet të ketë ardhur nga reformat fiskale si dhe reformat strukturore të ndërmarra përgjatë periudhës paraprake. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (shih grafikun 1), BPV në tremujorin e parë të vitit 2018 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ka shënuar rritje prej 3.5% në terma real dhe 4.7% në tremujorin e dytë, duke përfaqësuar një rritje të peshuar prej 4.1% në gjysmën e parë të vitit 2018.

Grafiku 1. BPV reale, sipas qasjes së shpenzimeve



Përgjatë periudhës raportuese, indeksi i çmimit të konsumatorit (IÇK) ka filluar të tregojë tendencë rritëse, kjo si rezultat i fillimit të ngritjes së çmimeve botërore të ushqimit dhe transmetimi i këtyre presioneve inflacioniste në vend, veçanërisht gjatë muajve Korrik-Shtator. Niveli i përgjithshëm i çmimeve gjatë kësaj periudhe shënoi rritje prej 1.4% siç mund të shihet edhe nga grafiku 2. Tendencë në rritje vazhdon edhe gjatë periudhës së mbetur të vitit 2018.

Grafiku 2. Indeksi i Çmimit të Konsumatorit




Si tregues i rëndësishëm i zhvillimeve të ekonomisë në vend u referohemi treguesve si numri i bizneseve të reja të regjistruara dhe përciptimet e bizneseve për ambientin e përgjithshëm biznesor. Nga të dhënat e ARBK-së (Tabela 1) vërejmë se në Kosovë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018 u regjistruan gjithsej 2,212 biznese të reja, që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak janë 3 biznese të reja të regjistruara më pak, ndërsa gjatë kësaj periudhe janë çregjistruar 339 biznese apo 41 biznese më shumë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar.

Tabela 1. Bizneset e regjistruara sipas aktiviteteve ekonomike

Sektori i regjistrimit të biznesit	TM3 2017	TM3 2018
Bujqësi, pylltari dhe peshkatar	245	145
Prodhim	225	214
Ndërtimtari	188	189
Tregti me shumicë dhe pakicë	529	519
Akomodim dhe akt. shërb.	208	212
Aktivite profesionale	186	182
Tjera	634	751
Totali	2,215	2,212


Pasi që pritet dhe vlerësimet e bizneseve vendore mbi pritjet ekonomike dhe të bërit biznes janë tregues të rëndësishëm për ecuritë ekonomike, në vijim janë të paraqitura të dhënat nga Oda Ekonomike e Kosovës të cilat pasqyrojnë pozitën e sektorëve sipas vlerësimeve të bizneseve.

Grafiku 3. Klima e të bërit biznes në TM3 2018




Të dhënat e tremujorit të tretë për vitin 2018 tregojnë se përshtypjet e shumicës së bizneseve lidhur me klimën e të bërit biznes kanë qenë pozitive. Megjithatë, kjo nuk vlen edhe për sektorin e ndërtimitarisë i cili në këtë tremujor tregon për klimë pozitive por me përkeqësim. Sektori i përpunimit, shitjes me pakicë dhe me shumicë dhe ai i shërbimeve, paraqesin përmirësime në pritshmëritë e tyre dhe vlerësime të tilla mund të vijnë për shkak të rritjes së aktivitetit ekonomik me ndikim tek sektorët e ndryshëm në përgjithësi.

Grafiku 4. Klima e biznesit në TM3 2018



Grafiku 5. Na prezanton pritjet e bizneseve për klimën që do të mbizotërojë për gjashtë muajt në vijim. Vlen të theksohet se në përgjithësi pritshmëritë e bizneseve janë pozitive por në kufi të asaj me përkeqësim dhe përmirësim, përveç sektorëve të shitjes me pakicë dhe shërbimeve të cilët pritshmëritë i kanë pozitive me përmirësim për sa i përket klimës që do të mbizotërojë në 6 muajt e ardhshëm. Ndërsa, sektori i përpunimit ka klimë pozitive por me pritshmëri për përkeqësim.

Grafiku 5. Pritjet e bizneseve në TM3 2018 për gjashtë muajt e ardhshëm



Sektori i Jashtëm

Bilanci i tregtisë së jashtme vazhdon të mbaj trendet negativ. Importi i mallrave edhe gjatë tremujorit të tretë ka vazhduar të ketë trend rritës, ku përgjatë periudhës korrik-shtator në raport me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm, ka shënuar rritje prej 10.9%. Tabela 2, tregon katër grupe produktesh që përbëjnë më shumë se gjysmën e importeve gjatë periudhës TM3.

Tabela 2. Importi sipas produkteve, në '000 euro

Kategoria	TM3 2017	TM3 2018
Ushqime të përgj. pije dhe duhan	115,770	115,345
Produkte minerale	118,702	144,528
Metale bazë dhe artikuluj prej tyre	90,577	109,078
Makineri, pajisje makinerie e elektrike	90,958	107,962
Të tjera	404,743	433,415
Totali	820,750	910,059

Në tabelën 3. Paraqitet struktura e importeve sipas shteteve, të dhënat e importit sipas shteteve na tregojnë se rreth 45% e importit total vjen nga shtetet e Bashkimit Evropian. Ndërsa, vendet me pjesëmarrje më të lartë të importit janë Gjermania, Serbia, Turqia dhe Kina. Sa i përket importit nga Turqia dhe Kina, kanë shënuar rritje në këtë tremujor prej 13.6% respektivisht 11.8%, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa vërehet rënie e importit nga Serbia prej 5.5%, në TM3 2018 krahasuar me TM3 2017.

Tabela 3. Importi sipas shteteve, në '000 euro

Shteti	TM3 2017	TM3 2018
Gjermania	96,982	99,219
Italia	62,401	59,211
Serbia	124,834	117,947
Turqia	75,630	85,929
Kina	78,190	87,381
Të tjera	382,713	460,372
Total	820,750	910,059

Sa i përket eksporteve gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018 ato kanë shënuar rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të mëparshëm.

Eksportet e mallrave gjatë kësaj periudhe arritën vlerën mbi 95.9 milionë euro, që në përqindje shënon rënie prej rreth 8.7%.

Tabela 4. Eksportet sipas produkteve, në '000 euro

	TM3 2017	TM3 2018
Produktet minerale	23,208	12,342
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	35,607	32,208
Plastika, goma dhe artikujt prej tyre	9,673	11,707
Të tjera	36,582	36,691
Total	105,070	95,948


Nga tabela 4. Shohim se ka rënie në eksportet e metaleve bazë dhe produkteve minerare prej 9.5% dhe 47%, respektivisht. Përderisa gjatë këtij tremujori shohim se ka rritje prej 21%, në eksportin e produkteve të plastikës dhe gomës dhe 15.3% në kategorinë ushqim, pije dhe duhan. Rreth 78% e eksporteve kosovare u destinuan në shtetet e CEFTA-s dhe të BE-së.

Tabela 5. Eksporti sipas shteteve, në '000 euro

Shteti	TM3 2017	TM3 2018
Gjermania	5,109	6,771
Italia	2,012	1,530
Bullgaria	2,083	1,949
Shqipëria	16,311	19,119
Maqedonia	13,848	11,167
Serbia	15,735	9,249
India	15,882	9,182
Kina	878	442
Të tjera	35,212	36,539
Total	105,070	95,948

Nga tabela 5 shihet rënie në eksport me vendet India, Serbia dhe Kina. Mirëpo, vërehet rritje e eksportit në Gjermani dhe Shqipëri, ndërkohë që vendet e CEFTA-s edhe më tutje vazhdojnë të mbesin partnerët kryesor për eksportin e mallrave. Duke pasur parasysh pjesëmarrjen dominuese të metaleve në eksportin kosovar, rënia e eksportit të këtij produkti vazhdon të ndikojë dukshëm në eksportin total, prandaj shohim një rënie prej 8.7% në eksportin total edhe për këtë periudhë.


Sa i përket bilancit të shërbimeve gjatë muajve Korrik-Gusht 2018 (pasi që ende nuk kemi të dhëna për muajin shtator, krahasimi do të bëhet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar) eksporti i shërbimeve ka treguar tendencë rënieje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, me 3.4% përderisa importi i shërbimeve krahasuar me periudhën e njëjtë është rritur për rreth 12.3%.

Grafiku 7. Bilanci tregtar

Sektori Fiskal


Të hyrat e përgjithshme buxhetore tregojnë një ngritje në tremujorin e tretë të vitit 2018 krahasuar me atë të kaluar në periudhën e njëjtë. Kjo ngritje shënon normën prej 4.8% ku të hyrat nga tatimet direkte janë për 5.7% më të larta kurse ato indirekte për 2.8% Kjo ngritje në arkëtim vjen si rrjedhojë e aktivitetit të shtuar ekonomik në vend, rritjen e vëllimit të shpenzimeve të sektorit privat dhe publik, përmirësimin e ambientit të të bërit biznes dhe efijencës së agjencive mbledhëse si rezultat i reformave strukturore.

Grafiku 8. Të hyrat, në milionë euro




Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve të përgjithshme, ato gjithashtu shënuan një ngritje prej 10.7% në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. një ngritje më e theksuar shihet tek shpenzimet rrjedhëse me 17.1%, ndërsa ato kapitale janë më të ulëta për 5.3% krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafiku 9. Shpenzimet, në milionë euro



Si rrjedhojë e ngritjes së të hyrave dhe nënëkzekutimit të shpenzimeve kapitale për këtë periudhë, deficiti primar sipas grafikut me poshtë tregon se është shënuar rënie në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafiku 10. Deficiti Primar, në milionë euro



Sektori Financiar


Sektori financiar në Kosovë vazhdon të mbetet mirë i kapitalizuar, likuid dhe profitabil. Kjo vërtetësi rezultat i përforcimit të procedurave konservative ndaj riskut kreditor. Duke u bazuar në të dhënat nga Banka Qendrore e Kosovës, depozitat shënuan një rritje prej 5.4% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Në anën tjetër, rritja e kredive ishte edhe më e madhe, duke arritur normën prej 11.4%. Asetet totale shënuan rritje prej 5.8%, duke arritur në 4.03 miliardë euro në fund të periudhës raportuese.

Tabela 6. Depozitat dhe kreditë në sektorin financiar, kumulative, fundi i periudhës (në milionë euro).

	TM3 2017	TM3 2018
Depozitat	3,047	3,210
Kreditë	2,407	2,681
Asetet Totale	3,811	4,033


Norma e interesit të kredive të reja është rritur nga 6.58% në tremujorin e tretë 2017, në 6.67% në tremujorin e tretë 2018. Ndryshim pozitiv shënoi edhe norma e interesit të depozitave të reja. Ajo shënoi rritje nga 1.07% në tremujorin e tretë 2017 në 1.47% në tremujorin e tretë 2018. Sipas të dhënave statistikore të Bankës Qendrore të Kosovës, sektori financiar vazhdon të mbetet një kontribuues i rëndësishëm në financimin e ekonomisë së vendit.

Grafiku 11. Trendi i normave të interesit dhe depozitave



Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2017, në tremujorin e tretë 2018, kreditë shënuan rritje të përcjellura nga depozitat të cilat gjithashtu

shënuan rritje. Ndryshime të tilla janë indikatorë të mirë që sektori bankar vazhdon të mbetet mirë i kapitalizuar. E tërë kjo si rezultat i përpjekjes për të ndjekur politikën e reformave të vazhdueshme për stabilitet makroekonomik dhe zhvillim financiar. Në grafikun 10, janë të paraqitura zhvillimet e depozitave dhe kredive ku trendi rritës është i dukshëm.



Grafiku 12. Trendi i kredive dhe depozitave

Tabelë përmbledhës

Përshkrimi	Njësia	2015	2016	2017				2018		
				TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3
SEKTORI REAL										
Bruto Produkti Vendor	çmime konst., ndryshimi në %	4.0	3.9	2.7	4.3	4.4	3.2	3.5	4.7	:
IÇK	ndryshimi në %	-0.5	0.3	1.6	1.9	1.7	0.7	0.0	0.7	1.4
Ushqimi dhe pijet	ndryshimi në %	0.4	-0.4	1.0	1.9	1.4	1.9	0.6	0.5	2.0
Çmimet e importit	ndryshimi në %	-1.2	-2.5	5.2	4.3	4.2	2.5	1.4	2.4	:
Çmimet e prodhimit	ndryshimi në %	2.7	-0.1	0.9	5.5	5.6	1.6	0.2	1.7	:
TREGU I PUNËS										
Norma e punësimit	ndryshimi në %	25.2	28.0	28.9	29.9	30.4	29.8	28.8	28.5	:
Norma e papunësisë	ndryshimi në %	32.9	27.5	30.5	30.6	30.2	30.6	26.5	29.4	:
Numri i bizneseve të regjistruara		9,833	10,424	2,861	2,266	2,241	1,951	2,587	2,657	2,212
Numri i bizneseve të ç' regjistruara		2,205	2,360	429	444	298	417	486	412	339
SEKTORI I JASHTËM										
Importi i mallrave	c.i.f., mil. euro	2,635	2,790	609	787	821	830	656	887	910
Eksporti i mallrave	f.o.b., mil. euro	325	310	76	103	105	94	73	96	96
Bilanci tregtar	mil. euro	-2,309	-2,480	-533	-684	-716	-736	-582	-791	-814
Importi i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	2,926	3,282	707	905	1,007	955	776	1,032	1,062
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	mil. euro	1,274	1,440	235	305	874	296	268	334	771*
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	mil. euro	-497	-481	-169	-252	232	-185	-157	-267	252*
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	% e BPV	-8.6	-7.9	-2.7	-4.0	3.8	-3.7	-8.4	-12	-16*
Investimet e Huaja Direkte	bilanci, mil. euro	309	220	65	84	64	42	31	49	42*
Remitancat	bilanci, mil. euro	609	636	149	183	183	194	170	214	136
SEKTORI FISKAL										
Të hyrat e përgjithshme <i>prej të cilave:</i>	mil. euro	1,457	1,596	339	415	475	453	362	439	498
Të hyrat nga tatimet direkte	mil. euro	198	232	57	62	60	59	73	71	64
Të hyrat nga tatimet indirekte	mil. euro	1,107	1,227	253	321	380	361	262	339	391
Shpenzimet e përgjithshme <i>prej të cilave:</i>	mil. euro	1,551	1,658	342	418	417	574	401	434	461
Shpenzimet rrjedhëse	mil. euro	1,149	1,221	286	315	296	386	320	332	347
Shpenzimet kapitale	mil. euro	404	444	56	103	121	188	81	102	114
SEKTORI FINANCIAR										
Depozitat	mil. euro	2,703	2,898	2,912	2,888	3,047	3,093	3,074	3,086	3,210
Kreditë	mil. euro	2,020	2,230	2,295	2,391	2,407	2,485	2,534	2,661	2,681
Asetet totale të sektorit financiar	mil. euro	3,385	3,637	3,670	3,671	3,811	3,876	3,873	3,891	4,033
Norma e interesit në kredi	%	8.3	7.5	7.3	6.7	6.6	6.8	6.9	6.7	6.7
Norma e interesit në depozita	%	0.9	1.01	0.9	1.0	1.1	1.1	1.1	1.1	1.4
Norma e këmbimit	EUR/EUR	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
Norma reale efektive e këmbimit	indeks	104.7	104.6	105.9	104.6	104.8	104.5	104.8	103.8	104.3

Burimet: Agjencia e Statistikave të Kosovës
Banka Qendrore e Kosovës
Thesari i Kosovës (Ministria e Financave)
Oda Ekonomike e Kosovës

(:) – nuk ka të dhëna; në këto raste, të dhënat janë të disponueshme vetëm për tremujorin si tërësi * të dhënat përfshijnë periudhën Korrik-Gusht, pasi që në kohën e publikimit të kësaj Pasqyre, nuk janë të publikuara të dhënat për muajin shtator/Diskrepancat e mundshme me publikime tjera të Njësive vijë si pasojë përpunimit të të dhënave nga BQK, pasuar edhe me revidim historik.

Përdorimi i të dhënave nga ky publikim lejohet vetëm me citimin e burimit. Pasqyra publikohet çdo tremujor dhe çdo përmirësim bëhet në faqen zyrtare në internet. Për çdo dallim mes versioneve, mbizotëron ai në gjuhën shqipe.

Departamenti për Politika Makroekonomike dhe
Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar
Njësia e Makroekonomisë
Tetor 2018